



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË**  
**AFATET E ANKIMIMIT**

1. **Drejtuar: Operatorit Ekonomik “BE - IS” Shpk**
2. **Adresa:** Tiranë, Vorë, Muçaj, Lagja Muçaj, Objekti Nr.Pasurie 321/26, Zona Kadastrale 2726, Bashkia Vorë
3. **OE/BOE me nënkontraktor**  
**PO** ☐ **JO** ☒
4. **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**  
**PO** ☐ **JO** ☒
5. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi
6. Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Procedurë e Hapur”**
7. Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 91863-07-01-2026**
8. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtimi rrugës “Dhimitër Xhuvani”.**
9. Fondi limit: **168,306,967.95** (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë milion e treqind e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
10. **Burimi i financimit:** me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, miratuar me miratuar me VKB Nr.100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026” të miratuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr. Prot 43563/1., datë 24.12.2025, dhe në mbështetje të ligjit nr. 162, datë 23.10.2020, “Për prokurim publik”.
11. Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj kalendarik.
12. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 02.07.2026
13. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr.42, datë 06.07.2026.

**14. KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” shpk

**NUIS J81527001Q**

Vlera: **95,779,933.41** (nëntëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e një) lekë pa TVSH

2. Operatori Ekonomik “ADDON” shpk

Vlera: **96,150,394.59** (nëntëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër pike pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

**3. Operatori Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” shpk**

NUIS J91915001P

Vlera: **100,285,764** (njëqind milion e e dyqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

**4. Operatori Ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk**

NUIS L78006801F

Vlera: **100,663,652.19** (njëqind milion e e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy pike nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

**5. Operatori Ekonomik “K A C D E D J A” shpk**

NUIS K51712017A

Vlera: **107,713,193.73** (njëqind e shtatë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH

**6. Operatori Ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk**

NUIS L52125110A

Vlera: **108,552,598.58** (njëqind e tetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë pike pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

**7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2 N” & “AVDULI” shpk**

NUIS L31615017L & J66703306O

Vlera: **110,000,000** (njëqind e dhjetë milion ) lekë pa TVSH.

**8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “M U R A T I” & “NDREGJONI” shpk**

NUIS J66702413V & K31329048I

Vlera: **113,045,212.50** (njëqind e trembëdhjetë milion e dyzet e pesë mijë e dyqind e dymbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

**9. Operatori Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk**

NUIS L42215009L

Vlera: **114,165,272.26** (njëqind e katërmëdhjetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy pikë njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

**10. Operatori Ekonomik “BE - IS” shpk**

NUIS K71412003A

Vlera: **114,746,091** (njëqind e katërmëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**11. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “VELLEZERIT HYSA” & “ERGI” shpk**

NUIS K12911201C & K02727229P

Vlera: **120,327,987.47** (njëqind e njëzet milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë pike dyzet e shtatë) lekë pa TVSH

**12. Operatori Ekonomik “CURRI” shpk**

**NUIS J67902718S**

Vlera: **121,027,964.48** (njëqind e njëzet e një milion e njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katë pikë dyzet e tetë) lekë pa TVSH

**13. Operatori Ekonomik “INERTI”**  
shpk

**NUIS J66926804L**

Vlera: **121,167,089.40** (njëqind e njëzet e një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntë pikë dyzet) lekë pa TVSH.

**14. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” shpk**

**NUIS K01730502W**

Vlera: **121,646,319.36** (njëqind e njëzet e një milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë pike tridhjetë e gjashtë ) lekë pa TVSH.

**15. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B93 II” & “ASI-2A CO” shpk**

**NUIS L52209050O & K53002402C**

Vlera: **125,597,232.21** (njëqind e njëzet e pesë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë dyqind e tridhjetë e dy pike njëzet e një ) lekë pa TVSH.

**16. Operatori Ekonomik “BAMI HOLDING” shpk**

**NUIS J94416206R**

Vlera: **125,645,467.03** (njëqind e njëzet e pesë milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e katëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë zero tre)lekë pa TVSH

**17. Operatori Ekonomik “MARVELS”S Construction Group SHPK**

**NUIS J77506312B**

Vlera: **126,330,304** (njëqind e njëzet e gjashtë mil lion e treqind e tridhjetë mijë e treqind e katër) lekë pa TVSH

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori ekonomik “ALBAVIA”shpk**

Operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10, ku është kërkuar” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “ALBAVIA” shpk ka deklaruar të njëjtin punonjës inicile H. GJ, në rolin e punonjësit Inxhinierit Elektrik edhe në rolin e punonjësit Teknik Elektrik, çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.5 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht: - 1 (një) Inxhinier Elektrik” si dhe pikën 2.3.10 të Kriteve të

Vecanta të Kualifikimit ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme ....., si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik”.

## **2. Operatori ekonomik “ADDON” shpk**

Operatori ekonomik “ADDON” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: 1- Teknik Topograf”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “ADDON” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “Blerimi” Shpk për 1 (një) Teknik Topograf, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90, pika 2, paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

## **3. Operatori Ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” shpk**

Operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë”

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve në kantier punonjës in me inicialet E.B, i cili rezulton të jetë i angazhuar në kontratën me objekt: “Rikualifikimi urban i zonës mbrapa pallateve të vjetra në rr. E Balshajve” si dhe kontratën me objekt “Ndertimi unaza Mustafa Koc-Veski-Kocaj, Asfaltim i unazës që lidh 5-së fshatrat”, me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontrata të cilat i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.6 ku është kërkuar: “Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: 1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testimi laboratorike te leshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testeve për materialet kryesore të ndërtimit (asfalt, beton), sipas kërkesave të projektit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “ALMO Konstruksion” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “K-Turja” Shpk për 1 (një) Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialeve, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90 pika 2 paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

#### **4. Operatori Ekonomik “L.T.E CONSTRUCTION” shpk.**

Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Librezë pune; b) Kontratë pune e vlefshme; c) Diplomë”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier punonjësin me inicialet E.D, i cili rezulton të jetë i angazhuar në kontratën me objekt: “Rehabilitimi i Infrastruktures rrugore ne Njësinë Administrative Vaqarr - Pezë – Ndroq”, me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, gërma g) ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 8)...” “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshekruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me autoritetin kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar mjetet Kamion me targe AA 916 SD, Rrul me vibrim kompresor Nr. Shasisë 101580201007 Fat. 01, dt.07.01.2021, Kamioncine me targe AB 716 DJ, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt "Ndertimi i ambienteve per shoqaten humanitare te invalideve paraplegjik dhe tetraplegjik te shqiperise, ne pronen 99, reparti ushtarak 5011 / 45, Surrel, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Opratori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit mjetet - Kamion me targe AA916SD, Rrul me vibrim kompresor Nr. Shasisë 101580201007, Kamioncine me targe AB716DJ, Makineri per skarifikim shtresash Fature Tatimore 50 date 07.03.2011 3787 Rep, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara, në kontratën e lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, me objekt: “Rehabilitimi i Infrastruktures rrugore ne Njësinë Administrative Vaqarr - Pezë – Ndroq” , kontratë së cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise”si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike)”, si më poshtë: 1- Teknik Topograf. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “LTE CONSTRUCTION” shpk është mbështetur te subjekti mbështetës “Varaku E” Shpk për 1 (një) punonjës Teknik Topograf, duke u mbështetur në më shumë se 50 % të kapacitetit teknik të lejuar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 90 pika 2 paragrafi i katërt, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

#### **5. Operatori Ekonomik “K A C D E D J A” shpk**

Operatori ekonomik “K a c d e d j a” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”: ...rul me (Kompresor me vibrim) cope 2, Asfaltoshtruese cope 2, Grejder cope 2, Autobitumatriçe cope 2, Fadrome cope 1. “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “Kacdedja” shpk ka deklaruar mjetet rul me vibrim SLBRO000Ë12CË017, rul me vibrim 9820437, Asfaltoshtrues Nr. Shasisë 0445, Grejder Fature nr.356 Date 27/04/2016, Autobitumatriçe me targe TR0344L, Fadrom me targe ADMT79, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt " Rikualifikim urban i zonës “Kodra e Diellit” – Faza II, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Operatori ekonomik “K a c d e d j a” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13 të dokumenteve standard të tenderit, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, dokumentacioni i skedave teknike për materialet bojra janë dokumente të paraqitura vetëm në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer në gjuhën shqipe, cka bie në kundërshtim me nenin 24, pika 2, paragrafi i dytë, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar) ku përcaktohet “Në procedurat e prokurimit nën kufinj të lartë monetar, gjuha e përdorur është gjuha shqipe” si dhe dokumentet standarde të tenderit “Njoftimi i kontratës, ”Seksioni 4, pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X.

## **6. Operatori Ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk**

Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3 ku është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndërtimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: Librezë pune; Kontratë pune e vlefshme; Diplomë...” Nga verifikimi i dokumentacionit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” ka deklaruar punonjësin me inicialet P.M me profesion inxhinier Hidroteknik si Drejtues Teknik të punimeve në objekt me kohë të plotë, në kundërshtim me pikën 2.3.3 të Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, DST si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, ku në nenin 8, pika 2, ku përcaktohet se: “... Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”....

Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”: .... Kamion me kapacitet 10- 20 ton cope 2, Asfaltoshtruese cope 2”. “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk ka deklaruar mjetet Kamion me kapacitet 10 -20 ton AB233GC, Asfaltoshtruese Voge Super 1600 2, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt " Nderhyrje rehabilituese në bllokun që kufizohet nga rruget "Ibrahim Rugova" - "Nikolla Tupa" - "Sami Frasheri" - "Brigada VIII" (në kuader të Walk 21)" të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.10 ku është kërkuar” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton

kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë: - 1 (një) Teknik Elektrik; Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit rezulton se operatori ekonomik “RAFIN COMPANY” Shpk ka deklaruar punonjësën me inicialet P.M në rolin e Teknikut Elektrik, i pajisur me Certificate Nr. 2488, lëshuar nga QTA, cka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.10 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.10, gjëra b), ku përcaktohet se: “Për punonjësën teknik ndërtimi, teknik topograf, teknik elektrik duhet të deklarohet emri/mbiemri, profili i punës, numri dhe data kontratë individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin”.

### **7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “2 N” & “AVDULI” shpk**

Bashkimi i operatorëve ekonomik operatori ekonomik “2N” Shpk & “AVDULI” shpk nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”: .... Rrull me (Kompresor me vibrim) copë 2, Asfaltoshtuese copë 2, Grejder copë 2, Autobitumatriçe copë 2, Kamion me kapacitet 3-5 ton copë 1, Autobot uji copë 1, Eskavator me goma copë 1, Kamion me kapacitet 10-20 ton copë 2. “Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratë të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “2N” shpk ka deklaruar mjetet Rrull (Kompresor me vibrim) me Nr. Fature 29/2024 datë 02.05.2024, Asfaltoshtuese Nr. Rep: 8779 Nr. Kol:4190, Grejder me nr shasie 28006610, Autobitumatriçe me targë AA506PU, Autobot Uji me targë AA264TV, Kamion me targë AA561UV, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt: “Ndërtim i rrugës që lidh pronën nr.99 Reparti Ushtarak nr.5011/45, Surrë me rrugën nacionale”, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “2N” shpk ka deklaruar mjetet Eskavator me goma me targë ALMT95, Kamion me targë AA991IN, Rrull (Kompresor me vibrim) me Nr. Fature 29/2024 datë 02.05.2024, Asfaltoshtuese Nr. Rep: 8779 Nr. Kol:4190, Grejder me nr shasie 28006610, Autobitumatriçe me targë AA506PU, Autobot Uji me targë AA264TV, Kamion me targë AA561UV, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt: “Rehabilitimi i rrugëve Hamide Dalipi, Ismail Klosi dhe degezimet e tyre”, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

### **8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “M U R A T I” & “NDREGJONI” shpk**

Bashkimi i operatorëve ekonomik “MURATI” shpk & “NDREGJONI” shpk nuk përmbush Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndërtimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontratë të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Librezë pune; b) Kontratë pune e vlefshme; c) Diplomë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “NDREGJONI” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier, punonjësën me inicialet P.D, i cili rezultoi të jetë i angazhuar në kontratën me objekt: “Nderhyrje rehabilituese në bllokun që kufizohet nga rruget "Ibrahim

Rugova" - "Nikolla Tupe" - "Sami Frasheri" - "Brigada VIII" (ne kuader te Walk 21)", me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Bashkimi i operatoreve ekonomike "MURATI" Shpk & "NDREGJONI" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.5, ku përcaktohet se: "Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht: - 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)"... Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se Bashkimi i operatoreve ekonomike "MURATI" Shpk & "NDREGJONI" shpk nuk ka deklaruar inxhinier ndërtimi me Profil Transport.

### **9. Operatori Ekonomik "PEPA GROUP GROUP" shpk**

Operatori ekonomik "PEPA GROUP" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...*" Autobitumatrice cope 2, Grejder cope 2, Asfaltoshtruese cope 2...g) "*Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit te cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi*". Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik "PEPA GROUP" shpk ka deklaruar mjetet Autobitumatrice AA456KK, Grejder AIMT87, Asfaltoshtruese nr shasie 47009 Nr. 5716 Rep, Nr.2385 Kol, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: "*Ndërtimi i ambjenteve të shërbimeve brenda zonës "TEDA"*", me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

### **10. Operatori Ekonomik "MARVELS"S Construction Group SHPK**

Operatori ekonomik "MARVELS"S Construction Group" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: "Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate drejtuesin teknik (inxhinier ndërtimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:a)Librezë pune; b)Kontratë pune e vlefshme; c)Diplomë". Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik "MARVELS"S Construction Group" shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier punonjësen me inicialet M.B, e cila rezulton të jetë e angazhuar në kontratën me objekt: "Rikualifikim Blloku që kufizohet nga rrugët "Haxhi Xhuzi" – "Rreze Drite" – "Halil Hoxha", me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare Operatori ekonomik "MARVELS"S Construction Group" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...*" Autobitumatrice cope 1, Grejder cope 1, Rul (Kompresor me vibrim) cope 2... gërma g) ku përcaktohet se: "Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit te cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi". Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik "MARVELS"S Construction Group" shpk ka deklaruar mjetet Autobitumatrice me targë AA230UL, Autobot uji me targë LA9619A, Fadrome me targë LA8501A, Grejder me nr shasie 89J909F, Rul

(Kompresor me vibrim) me fat Nr.25 datë 28.02.2025, Asfaltoshtruese nr shasie 1804, Eskavator me goma me targë AGMT88....etj, mjete të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratën me objekt: “Rikualifikim Blloku që kufizohet nga rrugët “Haxhi Xhuzi” – “Rreze Drite” – “Halil Hoxha”, me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

### **11. Operatori Ekonomik “CURRI” shpk**

Operatori ekonomik “CURRI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14 gërma d), ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë: Çertifikatën e menaxhimit të energjise SSH/DIN/EN/UNI ISO 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalente....”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” shpk nuk ka paraqitur çertifikatën ISO 50001:2018 për pasojë nuk përmbush kërkesën e pikës 2.3.14 për disponimin e Çertifikatës së menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/UNI 50001-2018.

Operatori ekonomik “CURRI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...”* - Grejder cope 2...Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “CURRI” shpk nuk përmbush kërkesën për dy mjete Grejder të kërkuar pasi ka deklaruar vetem 1 (një) mjet Grejder

### **12. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk**

Operatori ekonomik “INERTI” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.16, ku përcaktohet se: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8)...”* Autobot uji copë 1, Eskavator me goma copë 1, Rrul me (Kompresor me vibrim) copë 2, Grejder copë 2, Kamion me kapacitet 10-20 ton copë 2. *“Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “INERTI” shpk ka deklaruar mjetet Rrul (Kompresor me vibrim) me reference doganore Nr.9046, Grejder me Nr Rep 2413 Kol 1483, Autobot Uji me targë AA289GD, Kamion me kapacitet 10-20 ton me targë AA901EX, Eskavator me goma me targë ACMT93, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt “Rikonstruksion i rruges “Pjeter Budi”, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare. Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “INERTI” shpk ka deklaruar mjetet, Grejder me Nr Rep 2413 Kol 1483, , Autobot Uji me targë AA289GD, Kamion me kapacitet 10-20 ton me targë AA901EX, mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt “Rehabilitimi i rrugeve të bllokut që kufizohet nga rrugët "3 Deshmoret" - "Kadri Roshi" dhe "Panajot Pano”, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare.

### **13. Operatori Ekonomik “LIQENI VII” shpk**

Operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.3, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do*

të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Librezë pune; b) Kontratë pune e vlefshme; c) Diplomë. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “LIQENI VII” shpk ka deklaruar si drejtues teknik të punimeve me kohë të plotë në kantier punonjës nën inçialet R.O, i cili rezultoi të jetë i angazhuar në kontratën me objekt: “Rehabilitimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rruga “Elez Isufi”- “Kufiri Njesia Administrative Paskuqan”- “Lumi i Tiranës”- “Kastriotet” me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë të cilës i vazhdojnë efektet ligjore – teknike dhe financiare

#### **14. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B93 II” & “ASI-2A CO” shpk**

Bashkimi i operatoreve ekonomik “B93 II” Shpk & “ASI-2A CO” shpk nuk përmbushin Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.15 ku është kërkuar se: “Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezultoi se operatori ekonomik “ASI-2A CO” shpk ka paraqitur Liçensën 3.II B me nr. LN-2888-09-2021 dhe operatori ekonomik “B93 II” shpk ka paraqitur Liçencën 3.II B me nr. LN-7878-07-2024, të cilat janë licenca të lëshuara për transport të mbetjeve jo të rrezikshme, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.15, të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku është përcaktuar kërkesa për disponim të Liçencës për “Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin Ekonomik “BE - IS” shpk me adresë: “Tiranë, Vorë, Muçaj, Lagja Muçaj, Objekti Nr.Pasurie 321/26, Zona Kadastrale 2726, Bashkia Vorë”, me vlerë totale prej: **114,746,091** (njëqind e katërmëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.